

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
i  
RO-AG**

**KAPITULLI I**

**Emri, Forma, Selia, Kohegzjatja**

**Neni 1**

**Data e Themelimit dhe Emri**

- 1.1. Sot me date 28.02.2024 themelohet nga ortak/ortaket themelues, sipas legjislacionit shqiptar, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **RO-AG** (ne vijim "Shoqeria"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk".
- 1.2. Ortaku/Ortaket i/e Shoqerise ("**Ortaku**" / "**Ortaket**") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuote/a.
- 1.3. Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :
  - fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".
  - numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
  - adresa e regjistruar;
  - pasqyrimi i faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, nese aplikohet.
  - kapitalin e regjistruar dhe te paguar te Shoqerise.

**Neni 2**


**Forma Ligjore**

- 2.1. Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("**Ligji per Shoqerite Tregtare**").

**Neni 3**

**Selia**

- 3.1. Ne momentin e nenshkrimit te ketij akti, selia e Shoqerise ndodhet ne adresen:
- 3.2 Rruga "Ali Demi", Kompleksi "Wind" Kati i 5, Apartamenti 21, Shkalla A, Njesia Administrative Nr. 1 (Tiranë)



3.3 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë dege të saj ose zyra perfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 4 Kohegjatja**

4.1. Kohegjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

### **KAPITULLI II**

#### **Neni 5 Objekti i Shoqërisë**


5.1. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, dhe veçanërisht:

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja në çdo veprimtari apo aktivitet të ligshëm që mund të kryejë një shoqëri në përvojë të kufizuar e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar, sic mund të ndryshohet në mënyrë të ndryshme dhe në vecanti, por pa u kufizuar në: Kryerjen e aktivitetit në fushën e tregëtisë, ku përfshihen dhe industriale të çdo lloji natyre, si për llogari të vet ashtu edhe për të gërmimesh, levizje dherash, ndërtim galerish, ujësjellësish, shtrim rrugë, vepra arti në përgjithësi, si dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur me ndërtimin, projektimin, zbatimin e punimeve të ndërtimit dhe supervizionimit në përputhje me normat ligjore në fuqi, prodhimin dhe tregtimin e materialeve të ndërtimit dhe atyre ndimes. Prodhimin e materialeve inerte dhe të materialeve të tjera të nevojshme për punimet ndërtimore, sipërmarje e shërbime në fusha të ndryshme, kryerjen e çdo veprimtarie dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të shoqërisë; import eksport, tregtimin me shumicë e pakice i mallrave të ndryshme, industrial, si dhe mund të marrë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose ndermarje që kanë të njëjtin objekt, ose me objekt të lidhur me të etj. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mesipër, që mund të konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

#### **Neni 6 Ndryshime**

6.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

### **KAPITULLI III Kapitali Themeltar; Quota e Kapitalit Themeltar**



**Neni 7**  
**Kapitali Themeltar**

7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total **50.000 (pesedhjetemije)** i zoteruar teresisht ne 1 (nje) kuote/a (me tej "Kuota" /"Kuotat")

**Neni 8**  
**Ortaku/Ortaket dhe Kuota/Kuotat**

8.1. Ne daten e themelimit Shoqeria ka 1 (nje) Ortak i cili ka nenshkruar dhe zoteron Kuotat e Shoqerise, si me poshte :

- **Z. Agim Shera**, shtetas Shqiptar, i biri i Xhemal, lindur në Funares, më 29.08.1987, banues në Rruga Ali Demi", Kompleksi "Wind" Kati i 5, Apartamenti 21, Shkalla A, Njesia Administrative Nr. 1 Tirane – Shqiperi, mbajtës i dokumentit Pashaporte me Nr. BE2460612, Nr.personal I70829014Q, me date leshimi dt. 15.07.2019, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhjetemije) **lekë, që përbën 100 (njqind) % të kapitalit** të Shoqërisë **RO-AG** sh.p.k.;

**Neni 9**  
**Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit per Shoqerite.


9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

9.3 Rritja e kapitalit do te behet me leshimin e kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre do te paguhet plotesisht.

9.4. Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/ret te bejne blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe ti anulojne ato.

**Neni 10**  
**Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

10.1. Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuota ne Shoqeri.



10.2. Çdo Ortak do të ketë të drejtë të votojë me proporcionalitet me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotes së tij. Çdo Ortak ka të drejtë të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Shoqëritë.

10.3. Ortakut do t'i jepen, pas kërkesës me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.

10.4. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotes/tave, transferohen tek çdo zotëruar i ri për keto Kuota.

10.5. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban përgjegjësi brenda limitit të vlerës së Kuotes që zotëron. Ortaku nuk mban përgjegjësi mbi vlerën e investimit të tij në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata leshojnë).

10.6. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakeve të tij.

## **KREU IV**

### **Asambleja e Ortakeve/Ortaku i Vetem**

#### **Neni 11**

#### **Kompetencat**

11.1. Asambleja/Ortaku i Vetem është organi vendim marrës i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikën e saj ekonomike dhe tregtare.


#### **Neni 12**

#### **Mbledhja**

12.1. Asambleja/Ortaku i Vetem duhet të mbledhet të paktën 1 herë në vit.

12.2. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

12.3. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e të gjithë asetëve të Shoqërisë, sic rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Asambleja/Ortaku i Vetem do të vendosë mbi bazën e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, që do t'i



paraqitet, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.4. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga ortaku pasuri, qe kane vlerë me te larte se 5% e asetëve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

12.5. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortaku te Vetem i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.6. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortaku i Vetem mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e Administratoreve.

### **Neni 13 Menyra e Thirrjes**

13.1. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret te vendose per ceshjet e shtruara perpara tij nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.


13.2. Asambleja/Ortaku i Vetem mund te mblidhet nga nje prej Administratoreve ose me iniciativen e tij.

13.3. Asambleja/Ortaku i Vetem mblidhet ne seline e Shoqerise, ose ne ambientet e deges se Shoqerise apo ne cdo qytet, province apo shtet tjetër, siç bihet dakord nga Asambleja/Ortaku. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve i njoftohet Ortaku/Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes, se bashku me dokumentat e nevojshme te lidhura me ceshjet e rendit te dites. Ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem nuk eshte mbledhur/thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem eshte dakort.

13.4. Ortaku gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

13.5. Ortaku ka te drejten te votoje ne perputhje me vleren e Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

13.6. Vendimet e meposhtme do te merren me nje kuorum prej me shume se 1/2 e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:



- vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndrshem te fitimeve te Shoqerise;

- ndryshimi i Statutit;

- likujdim ose riorganizimin e Shoqerise;

- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;

Çdo vendim tjetër do të merret me një kuorum prej me shume se 30% te kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne 51% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje.

13.7. Ortaku/Ortaket do te njoftohen per permbajtjen e axhendes se mbledhjes.

13.8. Administratori/ret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit per Shoqerite dhe do te regjistrojne te gjitha vendimet e marra ne Regjistrin e Vendimeve.

#### **Neni 14**

#### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

14.1. Nje Ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur eshte duke vendosur mbi:

- vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

14.2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

#### **KREU V**


#### **Administratori/ret**

#### **Neni 15**

#### **Administratoreve dhe kompetencat**

15.1. Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume Administrator/re, sipas vendimit te Asamblese/Ortakut te Vetem. Administratori/ret mund te jete i çdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jete rezident ne Shqiperi.

15.2. Ne momentin dhe per qellimin e miratimit te ketij statuti administrator i Shoqerise eshte:



▪ **Z. Agim Shera**, shtetas Shqiptar, i biri i Xhemal, lindur në Funares, më 29.08.1987, banues në Rruga Ali Demi”, Kompleksi “Wind” Kati i 5, Apartamenti 21, Shkalla A, Njësia Administrative Nr. 1 Tiranë – Shqiperi, , mbajtës i dokumentit Pashaportë me Nr. BE2460612, Nr.personal I70829014Q, me date lëshimi dt. 15.07.2019, i cili emërohet per nje periudhë prej 5 (pese) vjetesh, nga data e themelimit te Shoqerise, te percaktuar ne kete dokument. Çdo ndryshim i mepaseshem ne lidhje me emerimin e Administratorit/reve nuk do te konsiderohet si nje ndryshim Statuti.

15.3. Administratori/ret emerohen per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh, te rinovueshme. Ne rast te me shume se nje Administratori kompetencat qe do te ushtrohen vecmas nga secili prej Administratoreve, nese ky eshte rasti, do te percaktohen ne vendimin e Asamblese/Ortakut te Vetem qe emerohet Administratoret.

15.4. Menjehere pas pranimit te emerimit te tij/tyre, Administratori(et) njohin ne se mardhenia e tyre me Shoqerine ndertohtet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Asamblese/Ortakut i Vetem gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre nga puna, ne perputhje me ligjet perkatese.

15.5. Asambleja/Ortaku i Vetem ka te drejte te shkarkoje Administratorin(ret) ne cdo moment.

15.6. Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, çështja do te referohet tek Asambleja/Ortaku i Vetem.

15.7. Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria mund t'u rimbursoje Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Adminsitrorit(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

## Neni 16

### Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit/reve

16.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) kerkesa/thirrjea e mbledhjes se Asamblese/ Ortakut te Vetem, ne rastet e specifikuara ne nenin 13;
- (ii) menaxhimin e aktivitetit te perditshem tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem;
- (iii) perfaqesimin e Shoqerise me palet e treta;

- (iv) kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- (v) pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecure se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim tek Asambleja/Ortaku i Vetem;

kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare e Biznesit, kur eshte e nevojshme;

- (vi) raportimin perpara Asamblese/Ortakut te Vetem, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;

- (vii) kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Asambleja/Ortaku i Vetem.

16.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshillaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaku ne lidhje me personat te cilët emerohen nga Ortaku.

## Neni 17

### Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

17.1. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,16,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, administratoret detyrohen:

- (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
- (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;

- (iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;

- (v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

17.2. Administratoret pergjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.





17.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka baren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidarare.

17.4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqofrese ne kundershkim me Ligjin per Shoqetite kryen veprimet e meposhtme:

- (i) i kthen Ortakeve kontributet;
- (ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividente;
- (iii) i shperndan asetet Shoqerise;
- (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
- (v) jep hua;

#### **KREU VI** **Administrimi Financiar i Shoqerise**

##### **Neni 18** **Eksperti Kontabel i Autorizuar**

18.1 Ortaku cakton ekspertin kontabel te autorizuar (auditues) per te dhene sherbimet e tij kudrejt Shoqerise.


18.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **KREU VII** **Aktiviteti Shoqerise**

##### **Neni 19** **Viti ekonomik-financiar**

19.1. Viti ekonomik-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

**Neni 20**  
**Mbajtja e Llogarive**



20.1. Shoqëria do të mbaje llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaja.

### **Neni 21 Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit**

21.1. Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të pasqyrave financiare të aprovuar nga Asambleja/Ortaku i Vetëm. Çdo ndryshim në destinacionin e fitimit do të caktohet nga Asambleja/Ortaku i Vetëm në përputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

21.2. Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, Shoqëria mund të shperndajë fitimin tek Ortaket vetëm nëse pas kësaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqërisë mbulojnë teresisht detyrimet e kësaj të fundit;
  - (ii) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm;
- 21.3. Administratorët leshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendëve, përmblush kërkesat e pikës 22.2 me sipër. Ndërsa kur gjendja e Shoqërisë tregon se shperndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush kërkesat sipas 21.2, Administratorët nuk mund ta leshojnë këtë certifikatë.

21.4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vertetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

### **KREU VIII Modifikimi i Formës Ligjore dhe Prishja**

#### **Neni 22 Modifikimi i Formës Ligjore**


22.1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblese/Ortakut të Vetëm në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin Shqiptar.

22.2. Shoqëria do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit të nevojshme në Shqipëri për këtë qëllim.

#### **Neni 23 Prishja e Shoqërisë**

23.1. Shoqëria mund të prishet në rrethanat e mëposhtme:

- (i) si pasoje e përfundimit të kohegjatjes për të cilin ishte themeluar;



- (ii) me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem;
- (iii) me hapjen e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne cdo kohe.

23.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”. Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

#### **KREU IX Te ndryshme**

##### **Neni 24 Largimi i Ortakut**

24.1. Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.

##### **Neni 25 Te tjera**

25.1. Cdo ceshnje tjetere, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

**Ortaku i Shoqerise**

**RO-AG SHPK**

Z. Agim Shera



**AGIM SHERA**